



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:220818

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05528265

C.nr.2109/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.H. dhe i mituri L.H. që të dy nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. B.B. nga Prishtina, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, të cilinë e përfaqëson me autorizim Kompania e Sigurimeve "S....." me seli në Prishtinë, e këtë autorizim e përfaqëson R.K. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 15.550,35 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prezencë të palëve, më datë **30.01.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve N.H. dhe L.H. që të dy nga Prizreni, **DETYROHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të demit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit më datën 21.10.2020, t'ia paguajë shumën si në vijim:

Për paditësen e parë N.H.

- për dhimbje fizike duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit shumën prej 1,250.00 €,
- për frikë duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit shumën prej 1,000.00 €,
- për ndihmë dhe kujdes të huaj shumën prej 300.00 €,
- për ushqim të përforcuar shumën prej 150.00 €,

Për paditësin e dytë L.H.

- për dhimbje fizike duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit shumën prej 3,500.00 €,
- për frikë duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit shumën prej 3,250.00 €,
- për zvogëlim të aktivitetit jetësorë në shkallë prej 3% shumën prej 3,000.00 €,
- për ndihmë dhe kujdes të huaj për 14 ditë shumën prej 196.00 €,
- për ushqim të përforcuar për 30 ditë shumën prej 150.00 €,

Respektivisht shumën e tërësishme prej 12,796.00 €, (dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro) me kamatë ligjore prej 8 %, duke e llogaritur atë nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor

pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, refuzohet si e pabazuar.

III. OBLIGOHET e paditura, që t'ia paguajë paditësve shpenzimet procedurale dhe atë në shumën prej 1,663.20 € (njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre euro e njëzet cent), në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit N.H. dhe i mituri L.H. me përfaqësuesen ligjore nëna e tij N.H. që të dy nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre avokat B.B. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate më datë 01.10.2021, ka paraqitur padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit. Në padi, paditësit kanë theksuar se më datë 21.10.2020, rreth orës 07:00, në rrugën Komuna e Prizrenit, ka ndodhur aksidenti i trafikut, nga i cili aksident paditësin kanë pësuar lëndime. Aksidenti ka ndodhur me fajin e personit NN, i cili dyshohet se drejtonte automjetin transportues kamionin me targa 04-21, me ngjyrë të portokalltë, në drejtim nga fshati Prevallë, nga pakujdesia dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes del në krahun e kundërt të lëvizjes në të cilën lëvizte paditësja N. H. e cila e drejtonte automjetin e markës VW Tiguan me targa dhe duke dashur që evitohet goditjen direkt e k paralajmëruar duke i rënë burisë, por përkundër këtyre veprimeve paralajmëruese nuk kishte zgjidhje tjetër, duke u detyruar që ta ndërrojë shiritin e lëvizjes duke goditur një shtyllë elektrike betoni, duke shkaktuar dëm material automjetit të cilin e drejtonte paditësja, nga ky aksident kanë pësuar dhe lëndime trupore, ku paditësja e parë N.H. ka pësuar lëndime të lehta trupore, ndërsa paditësi i dytë këtu i mituri L.H. ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Në fjalën përfundimtare dhe gjatë shqyrtimit kryesorë, i autorizuari i paditësve B.B. av. nga Prishtina, ka deklaruar se të gjitha format e dëmeve materiale dhe jo materiale u vërtetuan edhe me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës po ashtu edhe me ekspertizat mjekësore u vërtetua baza juridike e kësaj kërkesëpadie pasi që si në raportin e policisë edhe nga ekspertizat mjekësore dhe përgjigjet e dhëna nga ana e ekspertëve pasi që është bërë lidhja kauzale në mes të aksidentit të ndodhur më datë 21.10.2020, dhe lëndimet që i kanë pësuar paditësit, andaj përgjegjësia objektive bie mbi të paditurën. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë ka deklaruar se mbetet të tërësi pranë shumave të precizuara andaj me rastin e marrjes së aktgjykimit nga ana e kësaj gjykate kërkojë që e njëjta të aprovohet si e bazuar duke e detyruar të paditurën që ti paguaj paditësve shumat në lartësi ashtu siç janë precizuar me parashtrësën e datës 30.01.2024, dhe të detyrohet e paditurat që paditësve tua paguajë edhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej

312.00 euro, për përpilimin e parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 312.00 euro, në emër të përfaqësimit për dy seanca të mbajtura gjyqësore shumë prej 811.00 euro, për mungesë dalje nga zyra për çdo seancë gjyqësore nga 50 euro për dy seanca shumë prej 100.00 euro, për shpenzimet e udhëtimit Prishtinë – Prizren, për dy seanca gjyqësore nga 20 euro shumë prej 40.00 euro, në emër të pagesës për përpilimin e ekspertizave mjekësore (ortopedi – psikiatri) shumë prej 500,00 euro dhe në emër të taksës për padinë shumë prej 40,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

E paditura më datë 13.03.2023, ka dhënë përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve të pa bazuar për faktin se provat e bashkangjitura në padi nuk krijojnë bazë për kompensimin e këtij dëmi. Pasi që raporti policor është i përpiluar në bazë të deklaratës së paditëses apo drejtueses së automjetit B dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme për ta konstatuar rrjedhën e aksidentit. Duke shtuar se e paditura lidhur me kërkesën e paditësit në procedurë administrative ka kërkuar vendim që sillen provat-vërtetim se nuk është gjet shkaktari i aksidentit. Si pasojë e mungesës së provave relevante për sqarimin e bazës juridike të padisë dhe kërkesës së saj e deri në plotësimin e dokumentacionit e paditura nuk mund të deklarohet më gjerësisht lidhur me padinë dhe kërkesën e saj. Barra e provës bie mbi palën paditëse pas pranimit të provave shtesë për të sqaruar bazën juridike të padisë dhe kërkesës së saj, e paditura do të deklarohet përfundimisht lidhur me padinë dhe kërkesën e saj, në të kundërtën gjykatës i ka propozuar të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve tutje (BKS), në fjalën përfundimtare drejtpërdrejtë në procesverbal ka theksuar duke e kundërshtuar në tërësi parashtrësën e palës paditëse përkatësisht precizimin e kërkesëpadisë, duke e vlerësuar me shuma tejet të larta në krahasim me dëmet që janë shkaktuar në aksident, po ashtu duke qëndruar pran thënieve nga seancat e kaluara si dhe në shkresat e lëndës i ka propozuar kësaj gjykate që padinë dhe kërkesëpadinë përkatësisht precizimin e kërkesëpadisë ta refuzoj si të pa bazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Raporti i aksidentit të trafikut me nr.2020-GR-0579 datës 21.10.2020, Ekspertizën e ekspertit mjeko ligjor Ortoped – Traumatolog Dr. I.S. e datës 22.12.2023, Ekspertizën mjekësore e përpiluar nga eksperti gjyqësor Dr.sci. N.F. psikiatër nga Prizreni, e përpiluar më datë 22.11.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është **pjesërisht e bazuar**.

Përmes raportit të aksidentit me numër 2020-GR-0579 datës 21.10.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë vozitësi NN, i cili drejtonte automjetin transportues me targa 04-21 me ngjyrë të portokalltë në drejtim nga fshati

Reçan në Prevall nga pakujdesia dhe duke mos ju përshtatur shpejtësi së lëvizjes dhe del në krahun e kundërt të lëvizjes në të cilin krah voziste paditësja N.H. e cila drejtonte automjetin e markës VW Tiguan me targa të regjistrimit dhe duke dashur që të evitoj goditjen direkte e paralajmëron duke i rënë burisë, përkundër këtyre veprimeve paralajmëruese detyrohet që të ndërrojë shiritin e lëvizjes duke e goditur një shtyllë elektrike, në të cilën fatmirësisht ndalet duke shkaktuar dëm material si dhe lëndime pësojnë paditësit.

Në këtë rast, kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë, ashtu që për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata nga ekspertiza mjekësore të punuara nga Dr. I.S. - ortoped e datës 22.12.2023, në bazë të dokumentacionit mjekësor për paditësen e parë N.H. ka dhënë mendimin profesional përmes ekspertizës të punuara. Në bazë të ekspertizës është konstatuar se e dëmtuara N.H. ka pasur ndrydhje në regjionin e kraharorit me gërvishtje lëkure, ndrydhje në gjiun e djathtë, ndrydhje barku në anën e djathtë dhe ndrydhje të kërcirit në anën e majtë dhe si të tillë bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore të shkaktuara në aksidentin e datës 21.10.2021. Ka pasur dhembje fizike, me intensitet posaçërisht të rëndë 45 minuta, me intensitet të rëndë 24 orë, (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve), me intensitet të mesëm 21 ditë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve), dhembje fizike e intensitetit të lehtë në kraheror ka edhe sot. Nuk ka shëmtim trupor dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Ndihej dhe kujdesi i huaj 21 ditë. Ushqim përforcues ka qenë i nevojshëm deri në 30 ditë në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina, minerale dhe vitamina. Rehabilitim fizioterapeutik dhe klimaterik ka qenë i nevojshëm 10 ditë.

Ndërsa për paditësin e dytë këtu të miturin L.H. të cilin e përfaqëson përfaqësuesja ligjore nëna e tij N.H. është konstatuar se këtu paditësi L.H. ka pasur ndrydhje në kokë regjionit temporomandibulur (tëmthi dhe nofulla) tronditje trunore (comotio cerebri), lëndim i pësuar në aksidentin e datës 21.10.2020, i karakterizuar si lëndim i rëndë truporë. I cili lëndim i ka shkaktuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 45 minuta, dhembje fizike të intensitetit të rëndë 24 orë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes), dhembje fizike të intensitetit të mesëm 10 ditë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate) dhe dhimbje fizike e intensitetit të lehtë 1 muaj. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm është 3% bazuar në tronditjen trunore e klasifikuar nga tabela e BQK-së pika 1.2.1, ndihmë e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 14 ditë, ushqim përforcues ka qenë i nevojshëm deri në 30 ditë në përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina, minerale dhe vitamina dhe rehabilitim fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm 10 ditë.

Nga ekspertiza mjeko-ligjore psikiatrike e punuara nga Dr.sci. N.M.F. në bazë të dokumentacionit mjekësor paditëses N.H. dhe të miturit L.H. më datë 21.10.2020, kanë pësuar lëndime trupore dhe frikë në aksidentin e komunikacionit. Paditësja e parë N.H. ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur rreth 2-3 sekonda në momentin kur e ka perceptuar mundësinë e goditjes nga automjeti tjetër ose shtyllës dhe si pasojë rrezikun fatal të vdekjes e cila është manifestuar në formë të një bllokimi emocional. Ka përjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, e manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikën që shfaqej sa herë përballëj me

lëndimet e pësura dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten. E cila ishte përjetuar me prishje të gjumit, mendimeve negative, marramendje, plogështi dhe dridhje të trupit. Ka përjetuar edhe frikë të intensitetit të mesëm dhe atë dy javë e cila është manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e saj shëndetësore, nevojën e trajtimit të mëtejshëm mjekësor si dhe dhimbje e kohëpaskohshme në trup. Në këtë periudhë e njëjta ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, dhembje e trupit, ndjeshmëri të tepruar emocionale dhe nervozizëm të shtuar. Është konstatuar edhe frikë sekondare me intensitet të ulët që ka vazhduar rreth një viti e manifestuar me frikë dhe pagjumësi të kohë pas koshme, prishje të gjumit, nervozizëm, disponim të ulët, plogështi, ankesa somatike të shumta si dhe vështirësi gjatë përfshirjes në aktivitetet e lidhura me komunikacionin.

Paditësi i dytë L.H. për shkak të përjetimit të humbjes së vetëdijes nuk ka qenë e mundur të përcaktohet përjetimi i frikës primare. Ka përjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikën që shfaqej sa herë përballej me gjendjen e tij shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten. Ka përjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të mesëm tre javë e manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e tij shëndetësore, nevojën e mjekimit të mëtejshëm mjekësor si dhe dhimbje e kohëpaskohshme në kokë. Po ashtu në këtë periudhë ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, ndjeshmëri të tepruar emocionale dhe nervozizëm të shtuar. Është konstatuar se i njëjti ka pasur frikë sekondare me intensitet të ulët që ka vazhduar rreth një viti i manifestuar me frikë dhe pasiguri të kohë pas koshme, nervozizëm, mungesë vullneti dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin.

Me këto prova të administruara nga gjykata në emër të dhimbjeve fizike e aprovoj kërkesën e paditësve dhe atë për paditësen e parë N.H. në shumë prej 1,500.00 € ndërsa për paditësin e dytë L.H. në shumë prej 3,500.00 dhe e vlerësoj si shpërblim të drejtës dhe që i shërbejnë qëllimit të shpërblimit, sepse paditësit, sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped/traumatolog, paditësi i parë si pasojë e lëndimeve të marra, ka pasuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë që kanë zgjatur 45 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë 24 orë kohë pas kohe gjer në marrjen e terapisë adekuate, dhimbje të intensitetit të mesëm 21 ditë, orë kohë pas kohe gjer në marrjen e terapisë adekuate, dhimbje fizike e intensitetit të lehtë në kraharor ankon se ka edhe sot. Ndërsa paditësi e dytë si pasojë e lëndimeve të marra, ka pasuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë që kanë zgjatur 45 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë 24 orë kohë pas kohe gjer në marrjen e terapisë kundër dhimbjes, dhimbje të intensitetit të mesëm 10 ditë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, dhimbje fizike e intensitetit të lehtë 1 muaj.

Në emër të frikës së pësuar gjykata e ka caktuar shpërblimin për paditësen e parë N.H. shumë prej 1,000.00 € ndërsa për paditësin e dytë L.H. shumë prej 3,250.00 €, dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrit, Dr.sci. N. M. F. paditësi i parë ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur rreth 2-3 sekonda në momentin kur e ka perceptuar mundësinë e goditjes nga automjeti tjetër ose shtyllës dhe si pasojë rrezikun fatal të vdekjes, ka përjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë e manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballej me

lëndimet e pësura dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten. Ka përjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe atë për dy javë, e cila frikë është manifestuar me brengosje të vazhdueshme për gjendjen e saj shëndetësore, nevojën e trajtimit të mëtejshëm mjekësorë si dhe dhimbjet e kohë pas koshme në trup. Po ashtu në këtë periudhë ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, dhimbje në trupi, ndjeshmëri të tepruar emocionale dhe nervozizëm të shtuar. Është konstatuar edhe frikë sekondare e intensitetit të ulët që ka vazhduar rreth një viti i manifestuar me frikë dhe pasiguri të kohë pas koshme, prishje të gjumit, nervozizëm, disponim të ulët, plogështi, ankesë somatike të shumta si dhe vështirësi gjatë përfshirjes në aktivitetet e lidhura me komunikacionin. Ndërsa paditësi i dytë ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur rreth 24 orë të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballej me gjendjen e tij shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten, e cila është manifestuar me prishje të gjumit, mendime negative, shpërthime në vaj, nauze, dhembje në regjionin e kokës dhe dridhje të trupit. Ka përjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të mesëm tre javë, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e tij shëndetësore, nevojën e trajtimit të mëtejshëm mjekësor si dhe dhimbje e kohë pas KOHSHEM në kokë. Po ashtu në këtë periudhë ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, ndjeshmëri të tepruar emocionale dhe nervozizëm të shtuar. Po ashtu është konstatuar edhe frikë sekondare me intensitet të ulët, që ka vazhduar rreth një viti e përcjellur me frikë dhe pasiguri të kohë pas koshme, nervozizëm, mërzitje, mungesë vullneti dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin.

Në emër të dhimbjes për shkak të zvogëlimit të aktiviteti të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 3 %, për paditësin e dytë L.H. gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 3,000.00 € e ka vlerësuar si të drejtë duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped, bazuar në tronditjen trunore e klasifikuar nga tabela e BQK-së pika 1.2.1 dhe mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Lidhur me shumën e kompensimit të dëmit jomaterial, gjykata vendosi në kuptim të nenit 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Në emër të ndihmës dhe kujdes të huaj gjykata për paditësen e parë N.H. ka caktuar shumën prej 300 € kurse për paditësin e dytë L.H. ka caktuar shumën prej 196 €, duke u bazuar në bazë të ekspertizës të ortopedit, ku kjo ndihmë ka qenë e nevojshme për paditësin e parë 21 ditë ndërsa për paditësen e dytë 14 ditë e cila ka konsistuar në ndihmë në kryerjen e nevojave të përditshme jetësore, ku për bazë gjykata ka marrë pagën prej 250 € si pagë mesatare në Republikën e Kosovës dhe pasi që paditësit kanë pasur nevojë për këtë ndihmë pasi që në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata për paditësen e parë N.H. ka caktuar shumën prej 150 € kurse për paditësin e dytë L.H. ka caktuar shumën po ashtu 150 €, duke u bazuar në bazë të ekspertizës të ortopedit, paditësja e parë ka pasur nevojë për 30 ditë kurse paditësi e dytë po ashtu ka pas nevojë për 30 ditë, për ushqim të përforcuar dhe atë të pasur me proteina, minerale dhe vitamina, gjykata

konstaton se vlera prej 5 € për ditë do të kontribonte në pasurim të ushqimit të kërkuar si ushqim i përforcuar për paditësen e parë për 30 ditë gjykata ka vlerësuar si shumë prej 150.00 € dhe për paditësin e dytë për 30 ditë gjykata ka vlerësuar si shumë 150 €, si shumë adekuate për këtë ndihmë pasi që në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*.

Gjykata i mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizave të lartpërmendur, ngase ekspertizat përmbajnë elementet e nevojshme të të dhënave mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1 i LMD-së janë parashikuar llojet apo format e shërbimit të dëmit jo material dhe atë për dhimbje e pësuar fizike për frikën e pësuar etj.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se e paditura mban përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësve me rastin e lëndimeve gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditësve t’ia kompensoj dëmin, konform nenit 159 dhe 136 të LMD-së.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore që i janë shkaktuar paditësve, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke e vlerësuar si shpërblim realë dhe objektiv dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e dëmit.

Gjykata konsideron se shumata e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi paraqesin një satisfiksion moral dhe shpagim real për format e dëmit të pasuar të paditësve në aksidentin e komunikacionit, lëndimet dhe pasojat, duke marrë parasysh dhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 183 të LMD-së, standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës mbi shumata e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi ngase konsideroi se shumata e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila nevojitet që gjendja materiale të dëmtuarve të sillet aty ku do të ishte po mos të kishte ndodhur veprimi dëmtues. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shumata e kërkuara me precizimin e kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe nuk patën mbështetjeje në provat materiale, pra gjykata vendosi brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga pala ndërgjyqëse.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me kërkesë për kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 382 paragrafi 2 të LMD-së pasi që palët paditëse kamatën e kanë kërkuar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 452 par. 3 dhe 463 të LPK-së dhe tarifës zyrtare për përfaqësime dhe atë për shpenzimet si në vijim: për përpilimin e padisë në shumën prej 312 euro, për përfaqësim në dy seance gjyqësore në shumë prej 811.20 €, shpenzimet për pagesën e ekspertizave mjekësore 500 €, taksën gjyqësore në shumë prej 40 €, të gjitha në shumë prej 1.663.20 €.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2109/2021 më datë 30.01.2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.